



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr. 2608 Prot.

Vlorë, më 25/08/2023

**Lënda :** *Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ (Vendimet e kontabilizimit)*

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE


• Drejtoria së Burimeve Mbështetëse

Në respektim të Ligjit Nr.102, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, nenit 162 të Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Udhëzimit Nr.15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”, kërkojmë nga ana Juaj Shpalljen Publike të katër akteve administrativ – Vendimet e kontabilizimit të detyrimeve doganore (bashkëngjitur kopje të akteve) si vijon :

- Nr.48, me Nr.1962/1 Prot., datë 14/07/2023, i materializuar për subjektin “Shkëlqim Demaj” me kod personal G71202093D, me banim në Vlorë.
- Nr.49, me Nr.1963/1 Prot., datë 14/07/2023, i materializuar për subjektin “Aldo Danaj” me kod personal I60731059V, me banim në Vlorë.
- Nr.55, me Nr.2170/2 Prot., datë 07/08/2023, i materializuar për subjektin “SIMAK SHOES” sh.p.k, me NIPT L56517201K, me seli në Vlorë (Lagjja “Bashkimi”, Rruga “Sado Koshena”, Nr.10).
- Nr.59, me Nr.2187/2 Prot., datë 11/08/2023, i materializuar për subjektin “Ervis Yzeiri”, me kod personal I50808079O, me banim në Fier.

*Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,*

**KRYETAR**  
**Artan Bedinaj**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr.1962/1 Prot.

Vlorë, më 14/07/2023

**V E N D I M N R . 4 8**

Sot, më datë 14/07/2023, unë Kryetari i Degës së Doganës Vlorë, pasi mora në shqyrtim shkresën e Drejtorisë së Kontrolleve Paszhdoganimit / Aposteriori pranë Departamentit Operativ Hetimor në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave me Nr.10331 Prot., datë 21/06/2023, protokolluar me Tonën me nr.1823, datë 23/06/2023, me lëndë “Raport përfundimtar Kontrolli lidhur me Program Kontrollin Nr.10925/1 Prot., datë 17.06.2021”, si dhe deklaratën doganore IM.4 me R 3632, datë 26-03-2021,

**K O N S T A T O V A S E :**

Më datën 26/03/2021, pranë Degës së Doganës Vlorë, është paraqitur subjekti “Shkëlqim Demaj” me kod personal G71202093D, i përfaqësuar nga Agjensia Doganore “Alba Shipping” me kod J 031, për të deklaruar vendosjen në qarkullim të lirë të mallit të Tij, me deklaratën doganore IM.4 me R 3632.

Me deklaratën doganore të lartpërmendur, nga ana e subjektit është deklaruar malli autoveturë e përdorur Marka “Mercedes Benz”, Tipi “E 200”, Naftë, Vitprodhimi 2017, Cilindratë 1950 cc, me numër shasie WDD2130131A329275, pesha neto 1,680 kg, i deklaruar në kodin tarifor \*87033290\*. Bashkëngjitur deklaratës doganore ndodhej dokumentacioni doganor përkatës.

Në zbatim të legjislacionit doganor, konkretisht, në bazë të neneve 49, 66-70 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), neneve 148/169 të V.K.Msë nr.651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor” (i ndryshuar), pikës 17 të Udhëzimit Nr.3, datë 23.01.2018 “Mbi procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore” të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, shkresës nr.526 datë 12.01.2021 “Përditësim të dhënash” etj, nga ana e Drejtorisë së Kontrolleve Paszhdoganimit / Aposteriori, është proceduar me rikontrollin dhe shqyrtimin e vlerësimit doganor të autoveturave mbi praktikat doganore të kreut tarifor \*8703\*, për periudhën kohore Janar – Prill 2021, për vitin e prodhimit të mjeteve të zhdoganura 2011-2020 me vlerë zhdoganimi mbi 12,800 euro (e cila është vlera mesatare e mjeteve me vitprodhim nga 2011-2020), në përfundim të të cilit, kanë arritur në konkluzionin se praktika doganore IM.4 : R 3632, datë 26.03.2021 është propozuar të vlerësohet me çmimin 15,840 Euro (modeli më i afërt është C 200 D automatic Exclusive me cilindratë të njëjtë) + shpenzimet e transportit

300 Euro nga Gjermania. Detyrimi doganor i munguar është në shumën 45,510 lekë. Me shkresën Nr.12046 Prot., datë 05.07.2021 agjensia doganore Alba Shipping, si përfaqësuese e subjektit është njoftuar për të paraqitur pretendimet me shkrim pranë Drejtorisë së Kontrollleve të Akcizës dhe Paszhdoganimit mbi “Njoftimin paraprak të formularit të vlerësimit doganor”, në zbatim të pikës 2 të nenit 161 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.651 datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”. Rezulton se nga ana e agjensisë doganore është kryer observacion ndaj konstatimit të lartcitur, i cili është marrë në shyrtime nga ana e Drejtorisë së Kontrollleve Paszhdoganimit / Aposteriori dhe më tej nga kjo drejtori, është vijuar me shkresën Nr.10331 Prot., datë 21/06/2023, me lëndë “Raport përfundimtar Kontrolli lidhur me Program Kontrollin Nr.10925/1 Prot., datë 17.06.2021”. Autoriteti vendimmarrës ka proceduar me shkresën nr.1962 Prot Prot., datë 04/07/2023 me lëndë “*Dërgim informacioni mbi përfundimin e procedurës hetimore administrative dhe kërkesë për paraqitje kundërshtimesh me shkrim*”, ndaj të cilës nuk janë paraqitur kundërshtime. Për sa më lart, mbështetur në nenin 65 e vijues të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), V.K.M nr.651 datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, Udhëzimin 03, datë 23.01.2018 “Mbi procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore” të Ministrit të Financave,

#### V E N D O S A :

- Subjekti “Shkëlqim Demaj” me kod personal G71202093D, detyrohet të paguajë detyrimin doganor në shumën **45.510** (Dyzet e pesë mijë e pesëqind e dhjetë) lekë, për deklaratën doganore IM.4 me numër R 3632, datë 26/03/2021.
- Zyra e Financës, Borxhit Doganor këtu, të kryejnë menjëherë kontabilizimin e detyrimeve përkatëse dhe të zbatojnë procedurat ligjore në fuqi, me qëllim rikuperimin e detyrimeve doganore, ndërsa Zyra e Kontrollit aposterior të procedojë me rregullimin e situatës sipas pikës 1 të Vendimit.
- Kundër këtij vendimi, subjekti “Shkëlqim Demaj” me kod personal G71202093D, i lejohet të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, duke parapaguar 100 % detyrimin doganor (kundrejt amendimit të deklaratës doganore), në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.

**K R Y E T A R**

**Artan Bedinaj**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr.1963/1 Prot.

Vlorë, më 14/07/2023

**V E N D I M N R . 4 9**

Sot, më datë 14/07/2023, unë Kryetari i Degës së Doganës Vlorë, pasi mora në shqyrtim shkresën e Drejtorisë së Kontrollleve Paszhdoganimit / Aposteriori pranë Departamentit Operativ Hetimor në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave me Nr.10331 Prot., datë 21/06/2023, protokolluar me Tonën me nr.1823, datë 23/06/2023, me lëndë “Raport përfundimtar Kontrolli lidhur me Program Kontrollin Nr.10925/1 Prot., datë 17.06.2021”, si dhe deklaratën doganore IM.4 me R 4830, datë 21-04-2021,

**K O N S T A T O V A S E :**

Më datën 21/04/2021, pranë Degës së Doganës Vlorë, është paraqitur subjekti “Aldo Danaj” me kod personal I60731059V, i përfaqësuar nga Agjensia Doganore “C&C Service” me kod J 119, për të deklaruar vendosjen në qarkullim të lirë të mallit të Tij, me deklaratën doganore IM.4 me R 4830.

Me deklaratën doganore të lartpërmendur, nga ana e subjektit është deklaruar malli autoveturë e përdorur Marka “LAND ROVER HSE”, Tipi “RANGE ROVER”, Naftë, Vitprodhimi 2014, Cilindratë 4367 cc, me numër shasie SALGA2JF2EA171062, pesha neto 2,655 kg, i deklaruar në kodin tarifor \*87033290\*. Bashkëngjitur deklaratës doganore ndodhej dokumentacioni doganor përkatës.

Në zbatim të legjislacionit doganor, konkretisht, në bazë të neneve 49, 66-70 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), neneve 148/169 të V.K.Msë nr.651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor” (i ndryshuar), pikës 17 të Udhëzimit Nr.3, datë 23.01.2018 “Mbi procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore” të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, shkresës nr.526 datë 12.01.2021 “Përditësim të dhënash” etj, nga ana e Drejtorisë së Kontrollleve Paszhdoganimit / Aposteriori, është proceduar me rikontrollin dhe shqyrtimin e vlerësimit doganor të autoveturave mbi praktikat doganore të kreut tarifor \*8703\*, për periudhën kohore Janar – Prill 2021, për vitin e prodhimit të mjeteve të zhdoganuara 2011-2020 me vlerë zhdoganimi mbi 12,800 euro (e cila është vlera mesatare e mjeteve me vitprodhim nga 2011-2020), në përfundim të të cilit, kanë arritur në konkluzionin se praktika doganore IM.4 : R 4830, datë 21.04.2021 është propozuar të vlerësohet me çmimin 24,000 Euro (modeli është i njëjtë dhe cilindratë më e afërt është 3.0) + shpenzimet e transportit 300 Euro nga

Belgjika. Detyrimi doganor i munguar është në shumën 258,636 lekë. Me shkresën Nr.12025 Prot., datë 05.07.2021 agjensia doganore “C&C Service”, si përfaqësuese e subjektit është njoftuar për të paraqitur pretendimet me shkrim pranë Drejtorisë së Kontrolleve të Akcizës dhe Paszhdoganimit mbi “Njoftimin paraprak të formularit të vlerësimit doganor”, në zbatim të pikës 2 të nenit 161 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.651 datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”. Rezulton se nga ana e agjensisë doganore është kryer observacion ndaj konstatimit të lartcituuar, i cili është marrë në shqyrtim nga ana e Drejtorisë së Kontrolleve Paszhdoganimit / Aposteriori dhe më tej nga kjo drejtori, është vijuar me shkresën Nr.10331 Prot., datë 21/06/2023, me lëndë “Raport përfundimtar Kontrolli lidhur me Program Kontrollin Nr.10925/1 Prot., datë 17.06.2021”. Autoriteti vendimmarrës ka proceduar me shkresën nr.1963 Prot Prot., datë 04/07/2023 me lëndë “*Dërgim informacioni mbi përfundimin e procedurës hetimore administrative dhe kërkesë për paraqitje kundërshtimesh me shkrim*”.

Për sa më lart, mbështetur në nenin 65 e vijues të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), V.K.M nr.651 datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, Udhëzimin 03, datë 23.01.2018 “Mbi procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore” të Ministrit të Financave,

#### V E N D O S A :

- Subjekti “**Aldo Danaj**” me kod personal I60731059V, detyrohet të paguajë detyrimin doganor në shumën **258.636** (Dyqind e pesëdhjete e tetë mijë e gjashtëqind e tridhjet e gjashtë) lekë, për deklaratën doganore IM.4 me numër R 4830, datë 21/04/2021.
- Zyra e Financës, Borxhit Doganor këtu, të kryejnë menjëherë kontabilizimin e detyrimeve përkatëse dhe të zbatojnë procedurat ligjore në fuqi, me qëllim rikuperimin e detyrimeve doganore, ndërsa Zyra e Kontrollit aposterior të procedojë me rregullimin e situatës sipas pikës 1 të Vendimit.
- Kundër këtij vendimi, subjekti “Aldo Danaj” me kod personal I60731059V, i lejohet të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, duke parapaguar 100 % detyrimin doganor (kundrejt amendimit të deklaratës doganore), në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”.

**K R Y E T A R**

**Artan Bedinaj**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr.2170/2 Prot.

Vlorë, më 07/08/2023

**VENDIM Nr. 55**

Sot, më datë 07/08/2023, unë Kryetari i Degës së Doganës Vlorë, pasi shqyrtova Proces - Verbalin e shkeljes doganore me nr.2170 Prot., datë 20.07.2023, i mbajtur nga Grupit i Kontrollit, në ngarkim të subjektit "SIMAK SHOES" sh.p.k, me NIPT L56517201K, me seli në Vlorë (Lagjja "Bashkimi", Rruga "Sado Koshena", Nr.10), me përfaqësues ligjor z.Antonio Parente, me status në QKB "Aktiv", si dhe praktikën doganore,

**KONSTATOVA SE:**

Me shkresën Nr.2115 Prot., datë 17/07/2023, me lëndë "Kërkesë urgjente për eksport", nga ana e subjektit "SIMAK SHOES" sh.p.k, me NIPT L56517201K, është kërkuar ndihmesa institucionale e Degës së Doganës Vlorë, në lidhje me kryerjen e eksportit të produktit. Dega e Doganës Vlorë procedoi me zgjidhjen e situatës, duke kërkuar pranë organit epror zhbllokimin e nipt-it në sistem, deri në përfundim të procedurave të eksportit. Nga verifikimi i kryer, ka rezultuar se subjekti ka përpiluar praktikën doganore EX. 3 R 10280, R 10281, datë 17/07/2023, por mallrat nuk janë paraqitur në doganë për mbylljen e regjimit doganor. Në përfundim, u arrit në konkluzionin se nga ana e subjektit të mësipërm, është kryer shkelja doganore - kundërvajtje administrative, shkelje kjo e parashikuar në Dispozitat e Kodit Doganor dhe për këtë fakt u mbajtën akt konstatimet përkatës.

Për sa më lart, bazuar në nenet 239/2, 250/1/a, 252/e, 257/1/b, 262 të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i R. Shqipërisë" (i ndryshuar), V.K.M nr.651, datë 10.11.2017 "Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor",

**VENDOSA:**

- Subjekti "SIMAK SHOES" sh.p.k, me NIPT L56517201K, të penalizohet në shumën **50,000** (Pesëdhjetëmijë) lekë, bazuar në nenin 257/1/b të Kodit Doganor.
- Zyra e Financës, Borxhit Doganor këtu, të kryejnë menjëherë kontabilizimin e detyrimeve përkatëse dhe të zbatojnë procedurat ligjore në fuqi, me qëllim rikuperimin e detyrimeve doganore
- Kundër këtij vendimi, subjekti "SIMAK SHOES" sh.p.k, me NIPT L56517201K, i lejohet të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 "Kodi Doganor i R. Shqipërisë".

**KRYETAR**

**Artan Bedinaj**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr. 2187/2 Prot.

Vlorë, më 11/08/2023

**VENDIM Nr.59**

Sot, më datë 11/08/2023, unë Kryetari i Degës së Doganës Vlorë, pasi shqyrtova rekomandimin e lënë nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, i mbajtur në ngarkim të subjektit “Ervis Yzeiri” me ID. 1508080790, me banim në Fier (Rruga “Mujo Ulqinaku”, Nr.11/1, KP : 9305), si dhe pas marrjes në shqyrtim të Proces - Verbalit të konstatimit me nr.2187/1 Prot., datë 10/08/2023, i mbajtur nga ana e Grupit i Kontrollit,

**KONSTATOVA SE:**

Nga ana e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, është dërguar shkresa me Nr.441/10 Prot., datë 19/07/2023, protokolluar me Tonën me nr.144/10, datë 20/07/2023, me lëndë “*Dërgohet Raporti Përfundimtar për auditimin e kryer në Doganën Vlorë*”. Bazuar në këtë Raport Final, si dhe bazuar në legjislacionin doganor, pas një studimi të hollësishëm të tij, nga Dega e Doganës Vlorë u hartua “Plani i Punës” me nr.144/11 Prot., datë 04/08/2023, duke parashikuar në të, masat dhe Zyrat (personat) përgjegjëse të ngarkuara për zbatimin e detyrave konkrete. Nga ana e Grupit të Punës është kryer rishqyrtimi i rekomandimit të lënë ndaj këtij subjekti.

Në kontrollin dhe verifikimin e deklaratës doganore IM.4 R 5748, datë 10.05.2021, me të cilën nga ana e subjektit “Ervis Yzeiri” me ID. 1508080790, i përfaqësuar nga Agjensia Doganore “Gad.Universi” me kod J 102, është deklaruar artikulli (malli) “Gomone epërdorur Marlin 760; gjatësia 7.48 mt; gjerësia 3.09 mt; me një motorr”, me peshë neto 2,600 kg, klasifikuar në kodin tarifor \*89031090\*. Ky artikull është deklaruar nga ana e subjektit me vlerën 500 Euro/m<sup>2</sup>. Nga shqyrtimi i dokumentacionit tregtar bashkëngjitur praktikës doganore në sistemin Asycuda World, konstatohet se kjo deklaratë doganore nuk përmbush kushtet për vlerësim sipas metodës së transaksionit.

Nuk mund të kundërshtohet fakti se subjekti në procedurë ka paraqitur dokumentacionin në përpjekje për të provuar se vlera e deklaruar prej Tij është vlera e paguar për mallin lëndor, mirëpo, në procedurën e administrimit të provave, dokumentacioni përcjellës i mallit, është vlerësuar nga organi konstatues si provë e pamjaftueshme, për arsye se në dokumentacionin e deklaratës doganore, mungon kontrata e shitblerjes e lidhur midis eksportuesit dhe importuesit për çmimet e mallit, kushtet dhe mënyrën e pagesës së mallit, dëshmitë mbi mënyrën e porosisë së mallit, kushtet e dërgesës, etj,

andaj edhe nuk mund të veprohet ndryshe, që malli të vlerësohet sipas dokumentacionit të prezantuar, pasi subjekti, nuk ka paraqitur dokumentacion të besueshëm dhe të kompletuar për të provuar se çmimi i deklaruar është çmimi real i paguar me mallin lëndor kontestues dhe në rastin konkret, vlera e deklaruar nuk do të pranohet si vlerë reale e paguar për mallin lëndor kontestues, me arsyet e cekura më lart. Gjithashtu, referuar importeve dhe deklarimeve të të njëjtit artikull nga sistemi ORACLE, rezulton se i njëjti artikull në këtë degë doganore, nga sektori i vlerës në D.P.D është rivlerësuar sipas metodës 3 të vlerësimit me 0.7 euro/kg EU. Për këto arsye, pas marrjes në shqyrtim të rekomandimit të lartpërmendur, nga ana e grupit të kontrollit, është mbajtur Proces – Verballi i konstatimit nr.2187/1 Prot., datë 10-08-2023.

Për sa më lart, mbështetur në kreun III “Vlera për qëllime doganore” neni 65 e vijues të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), V.K.M nr.651 datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, Udhëzimin 03, datë 23.01.2018 “Mbi procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore” të Ministrit të Financave,

#### V E N D O S A :

- Subjekti “Ervis Yzeiri” me ID. I508080790, me banim në Fier, detyrohet të paguajë detyrimin doganor në shumën **24,061** (njëzet e katër mijë e gjashtëdhjet e një) lekë, për deklaratën doganore IMP. 4 me numër R 5748, datë 10/05/2021.
- Zyra e Financës, Borxhit Doganor këtu, të kryejnë menjëherë kontabilizimin e detyrimeve përkatëse dhe të zbatojnë procedurat ligjore në fuqi, me qëllim rikuperimin e detyrimeve doganore.
- Zyra e Mbikqyrjes Doganore të procedojë me rregullimin e situatës sipas pikës 1 të Vendimit.
- Kundër këtij vendimi, subjekti “Ervis Yzeiri” me ID. I508080790, i lejohet të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, duke parapaguar 100 % detyrimin doganor (kundrejt amendimit të deklaratës doganore), në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.

**KRYETAR**

**Artan Bedinaj**

